



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministarstvo Finansija - Ministry of Finance

Departamenti për Politika Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar

Buletini Ekonomik Tremujor **Janar- Mars, 2020**

Buletini Ekonomik Tremujor ofron një përditësim të disa prej zhvillimeve kyçe brenda disa sektorëve të ekonomisë. Buletini është dizajnuar me qëllim që të jetë informativ për të gjithë lexuesit. Meqenëse efekti i pandemisë COVID 19 në ekonomi ka filluar relativisht vonë në muajin mars, ky buletin përfshin analiza bazuar në një numër të treguesve që janë të disponueshëm për këtë periudhë. numri i ardhshëm i buletinit (Prill-Qershor) do të përfshijë analizë të detajuar lidhur me ndikimin e pandemisë në ekonomi.

Përmbajtja

Zhvillimet e Ekonomisë së Jashtme	3
Spektori Real	4
Rritja Ekonomike	4
Spektori i Jashtëm	7
Llogaria Rrjedhëse	7
Llogaria Financiare	9
Spektori Financiar	9
Tregu i Punës	10
Regjistri i bizneseve, T1 2020	10
Financat Publike	11
Të hyrat	11
Shpenzimet	12
Bilanci i përgjithshëm buxhetor	12
Informata të Tjera: Reagimi i Autoriteteve Publike Ndaj Pandemisë Covid-19 në Kosovë	13


Zhvillimet e Ekonomisë së Jashtme

Zhvillimet ekonomike gjatë tremujorit të parë janë ndikuar ndjeshëm nga përhapja e virusit COVID-19. Në fillim të vitit, treguesit globalë të aktivitetit ekonomik tregojnë për një stabilizim të rritjes së prodhimit, me disa shenja të rimëkëmbjes në sektorin e prodhimit. Për më tepër, marrëveshja tregtare SHBA-Kinë e cila u nënshkrua në janar dhe ratifikimi i marrëveshjes BREXIT uli pasigurinë që ishte e pranishme në vitin 2019. Sidoqoftë, përhapja e shpejtë e COVID-19 në Evropë drejt fundit të shkurtit ndikoi ndjeshëm aktivitetin ekonomik. Pandemia ka bërë që shumë qeveri të marrin masa që kufizojnë lëvizjen e njerëzve dhe një pjesë të konsiderueshme të aktivitetit ekonomik. Si pasojë, masat e distancimit social kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen afatshkurtër ekonomike globale. Pavarësisht kësaj, ka ende paqartësi në lidhje me ndikimin gjatë pjesës tjetër të vitit.

Shumë vende evropiane deklaruan gjendje emergjente dhe ndërmorën masa për kufizime të lëvizjes dhe ndalime të disa veprimtarive në sektorë të ndryshëm të shërbimeve, siç janë hotelet dhe restorantet dhe tregtia me pakicë. Prodhimi gjithashtu u ngadalësua në disa sektorë prodhues, siç është industria e makinave, për shkak të rënies së kërkesës dhe ndërprerjes së zinxhirit të furnizimit. Vlerësimi i ndikimit dhe kohëzgjatja e kësaj goditjeje në ekonomi karakterizohet me shumë pasiguri.

Vlerësimi preliminar nga Eurostat, tregon se BPV-ja në baza vjetore është kontraktuar me 3.3% dhe 2.7% gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 në Eurozonë dhe BE, respektivisht. Kjo rënie ekonomike ishte rënia më e madhe në BE dhe Eurozonë që nga viti 1995. Përkeqësimi i perspektivës të rritjes ekonomike ka çuar në një rënie të theksuar të çmimeve të aksioneve dhe një rritje të pasigurisë.

Grafiku 1 çmimet në tregjet ndërkombtare



Në të njëjtën kohë, tregjet e mallrave janë goditur nga pandemia, e cila tashmë ka shkaktuar një ngadalësim të theksuar në aktivitetin ekonomik. Pandemia ka ndikuar si në kërkesën agregate ashtu edhe në furnizimin e mallrave përmes ndikimit të masave kufizuese në aktivitetin ekonomik dhe

në zinxhirin e furnizimit. Si rrjedhojë, çmimet e mallrave në tregjet ndërkombëtare¹ kanë shënuar një rënie të theksuar gjatë tremujorit të parë. Tendenca rënëse për disa mallra kishte filluar që nga janari, megjithatë në muajin shkurt kur numri i shteteve të prekura nga COVID19 u rrit, rënia e

¹ IMF primary commodity prices <https://www.imf.org/en/Research/commodity-prices>

çmimeve u përshpejtua. Ndërsa, rënia më e shpejtë e çmimeve shihet në muajin mars, pikërisht kur masat e kufizuese u rritën në shumë vende. Rënie e theksuar u regjistrua në çmimet që ndërlidhen me industrinë e transportit. Ndryshimet në çmimet e naftës në veçanti përcaktohen kryesisht nga faktorët e ofertës dhe kërkesës. Në 2020T1, rënia në kërkesën për naftë ishte e lidhur kryesisht me ngadalësimin ekonomik të shkaktuar nga pandemia COVID-19 e cila ka ndikuar në uljen e çmimeve të naftës. Çmimi i naftës bruto në muajin mars arriti mesatarisht 32 \$ / miliardë për fuçi, duke shënuar një rënie vjetore prej afër 50%.

Sektori Real

Rritja Ekonomike

Ecuria Makroekonomike 2019


Në mungesë të të dhënave zyrtare nga ASK-ja për BPV-në në tremujorin e parë të 2020-ës, në këtë botim të Buletinit analizohen të dhënat më të fundit të disponueshme, që i përkasin tremujorit të katërt të 2019-ës dhe më tej ofrohet një vlerësim cilësor për pritjet e aktivitetit ekonomik për tremujorin e parë të 2020-ës.

Në tremujorin e katërt të vitit 2019, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), ekonomia e Kosovës u rrit me 3.9% (v-m-v) në terma realë dhe me 4.3% (v-m-v) në terma nominalë.


Norma reale e rritjes në tremujorin e katërt të 2019-ës, kryesisht i atribuohet konsumit privat dhe qeveritar (me kontribut 2.4 p.p dhe 1.0 p.p, respektivisht) dhe investimit total (1.3 p.p). Kontributi i eksporteve neto rezultoi negativ (0.4 p.p), kryesisht si rezultat i kontributit në rënie i eksporteve totale (2.3 p.p).

Sipas të dhënave preliminare të BPV-së, ekonomia e Kosovës gjatë gjithë vitit 2019 u rrit me mesatarisht me rreth 4.2%, e cila është e krahasueshme me rritjen ekonomike të tre viteve të fundit.

Grafiku 2 Kontributet në BPV



Grafiku 3 BPV reale sipas aktiviteteve, v-m-v, %



Në tremujorin e katërt të 2019-ës , bazuar në ndarjen e BPV-së sipas aktiviteteve ekonomike, sektori i “shërbimeve”² vazhdon të ketë kontributin më të lartë në rritjen reale të BPV-së (rreth 1.9 p.p.), për t’u ndjekur nga sektori i “industrisë” (rreth 0.4 p.p) dhe nga sektori i “ndërtimtarisë” (rreth 0.2 p.p).³ Ndërkohë, sektori i “ Bujqësisë, Pylltarisë dhe Peshkimit” ka shfaqur një kontribut shumë afër zero.

Pritjet për ecurinë makroekonomike për T1 2020

Në mungesë të të dhënave zyrtare nga ASK-ja për BPV-në në tremujorin e parë të 2020-ës, indikatorët indirektë të kërkesës agregate japin sinjale për rritje më të ngadaltë ekonomik se në vitin paraardhës:

- Sinjalet për ecurinë e konsumit privat gjatë 2020T1 tregojnë për një rritje më të ngadaltë se në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar, mbështetur nga rritja më e vogël e mbledhjes së TVSH-së (4.7%, v-m-v); rritja më e ngadaltë e remitencave dhe kompensimit të punëtorëve (6.9% dhe 1.3%, respektivisht), edhe pse ecuria e importit të mallrave të konsumit dhe kredisë së re për konsum ka qenë e kënaqshme gjatë këtij tremujori.
- Konsumi publik⁴ është rritur me rreth 1.1% në tremujorin e parë të 2020-ës (v-m-v). Kjo normë është ndjeshëm më e ulët se rritja në vitin paraardhës.
- Sinjalet për investimet private janë pozitive dhe sugjerojnë një përshpejtim të rritjes në 2020T1, si rezultat i: *i*) rritjes së importit të mallrave kapitale me 7.41% (v-m-v), përshpejtimin të kredisë së re për qëllime investimi me 66.7%; dhe *ii*) rritjes së investimeve të huaja direkte me rreth 60.5%;
- Dinamika e investimeve publike në T1 2020, ashtu siç pritej për shkak të ndërrimit të qeverisë dhe mungesës së buxhetit të aprovuar, ka qenë e dobët, duke shënuar një rënie vjetore prej 34.9% (v-m-v).
- Deficiti tregtar i mallrave dhe shërbimeve në tremujorin e parë të 2020-ës është rritur me rreth 4.6 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kryesisht si rezultat i rënies së suficitit të bilancit të shërbimeve.

Inflacioni

Në T1 2020, Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) u rrit mesatarisht me rreth 1.1% në terma vjetorë. Kjo normë është më e ulët se norma e inflacionit e regjistruar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (rreth 3.2%). Dinamika mujore e ecurisë të inflacionit shfaq shenja ngadalësimi, duke shënuar një normë vjetore prej 1.5%, 0.9% dhe 0.8% në muajt janar, shkurt dhe mars 2020, respektivisht. Kjo ecuri rënëse i atribuohet më së shumti rënies së çmimeve të mallrave bazë në

² Sektori i shërbimeve përfshin kategoritë: “tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave”, “transporti dhe magazinimi”; “hotelet dhe restorantet”; “informimi dhe komunikimi”, “aktivitetet financiare dhe te sigurimit”; “afarizmi me pasuri të patundshme”, “administrimi publik” dhe “shërbime të tjera”.

³ Sektori i industrisë përfshin kategoritë: “industria nxjerrëse”, “industria përpunuese”, “furnizimi me energji elektrike dhe gaz”, dhe “furnizimi me ujë”.

⁴ Konsumi Publik përfshin dy kategori të shpenzimeve: “paga dhe mëditje” dhe “mallra dhe shërbime” dhe “shpenzime publike”.

tregjet ndërkombëtare, si rezultat i fillimit më të hershëm të situatës pandemike Covid-19 në vendet e tjera (SHBA, Kina, vendet e BE-së, etj).


Nënkategoritë e IÇK-së që treguan rritjen më të lartë ishin:

- Kategoria e ushqimit me një rritje vjetore prej 1.4% dhe një kontribut në inflacionin total prej 0.5 p.p. (kryesisht si rezultat i rritjes së çmimit të "bukës dhe drithërave" , "mishit" dhe "pemët");
- Kategoria e pijeve joalkoolike (me një rritje vjetore prej 3% dhe kontribut prej 0.16 p.p);
- Kategoria "Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" vazhdoi të kishte kontribut të ngjashëm me dy tremujorët paraardhës, me rreth 0.16 p.p (ritje vjetore prej 2%);
- Kontributi i kategorisë "mallra dhe shërbime të ndryshme" u rrit në 0.18 pikë të përqindjes, duke shënuar një rritje vjetore prej 3.7%;


Tabela 1 Kontributet e kategorive kryesore në inflacionin vjetor

Nën kategoritë kryesore të IÇK	2017	2018				2019				2020
	mes.	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1
Ushqimi dhe pijet jo-alkoolike	0.60	0.24	0.25	0.87	1.12	2.54	2.54	1.97	1.27	0.64
<i>prej të cilave: Ushqimi</i>	0.46	0.19	0.27	0.89	1.15	2.51	2.53	1.85	1.09	0.49
<i>Buka dhe Drithërat</i>	0.06	0.22	0.14	0.13	0.38	1.08	1.28	1.36	0.79	0.24
<i>Pemët</i>	0.12	0.18	-0.02	-0.05	-0.19	-0.20	-0.15	-0.05	0.11	-0.01
<i>Perimet</i>	0.05	-0.10	0.12	0.43	0.46	0.93	0.66	-0.03	-0.20	0.02
Pijet alkoolike dhe duhani	0.18	0.09	0.13	0.13	0.16	0.13	0.15	0.15	0.11	0.13
<i>prej të cilave: Duhani</i>	0.19	0.10	0.09	0.09	0.08	0.11	0.12	0.09	0.08	0.02
Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0.01	-0.05	-0.03	-0.01	0.00	0.01	0.11	0.15	0.16	0.14
Përdorimi i pajisjeve për transportin personal	0.36	0.04	0.37	0.75	0.83	0.40	0.25	-0.01	-0.14	-0.10
IÇK (v-m-v, %)	1.47	-0.03	0.72	1.38	2.16	3.20	3.26	2.56	1.67	1.07

Grafiku 4 Inflacioni total ndaj inflacionit bazë



Grafiku 5 Kontributi i inflacionit të treg. dhe patregt.



Inflacioni bazë⁵ në tremujorin e parë të 2020-ës, i matur duke përjashtuar kategoritë "ushqim dhe pije jo-alkoolike" dhe "transporti", shënoi një rritje vjetore prej 0.8%, që është më i ulët se sa inflacioni total (1.7%) për këtë periudhë.

⁵ Inflacioni bazë mat ndryshimin e çmimeve të produkteve të shportës së konsumatorit, duke përjashtuar luhatshmërinë e përkohshme dhe tranzitore, e cila kryesisht karakterizon kategorinë e ushqimeve apo të energjisë.

Siç shihet në grafikun 4, komponenti i inflacionit të tregtueshëm⁶ në 2020T1 vazhdon të përcaktojë sjelljen e inflacionit total dhe vlerësohet të ketë një kontribut rreth 0.92 pikë të përqindjes, ndërkohë që kontributi i komponentit të inflacionit të pa-tregtueshëm vazhdon të ngelet neglizhent.

Sektori i Jashtëm

Llogaria Rrjedhëse

Deficiti tregtar i mallrave në tremujorin e parë të vitit 2020 arriti vlerën prej 580.5 milionë €.

- Importi i mallrave gjatë tremujorit të parë të 2020-ës shënoi një rritje vjetore prej rreth 3.4%, duke shënuar ngadalësim krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kontribut më të theksuar shënuan kategoritë e importeve të artikujve ushqimorë (1.9 p.p.); produkteve të perimeve (1.2 p.p.); dhe mjeteve të transportit (1.1 p.p.). Ndërsa kontributi negativ më i lartë prej 1.6 p.p. erdhi nga produktet minerale.
- Eksporti i mallrave gjatë tremujorit të parë 2020 shënoi një rritje vjetore prej 25.7%. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga përshejtimi në ecurinë e eksportit e të metaleve bazë në fillim të 2020-ës, me një kontribut pozitiv prej 22.5 p.p në ecurinë e eksportit total. Eksporti i plastikës dhe artikujve të saj dhe eksporti i produkteve të industrisë kimike gjithashtu kishin kontribut pozitiv me (2.2 p.p.) dhe (1.9 p.p.), respektivisht. Ndërsa, kontributi i produkteve mineraleve ishte negativ me rreth 5.5 p.p..

Suficiti tregtar i shërbimeve për tremujorin e parë të 2020-ës është 137.8 milionë € dhe është rreth 11.5% më i ulët se bilanci në periudhën e njëjtë të vitit 2019.

- Eksporti i shërbimeve për tremujorin e parë të vitit 2020 ishte 3.1% më i ulët se ai në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Përkundër një kontributi pozitiv të eksportit të shërbimeve kompjuterike prej (0.8 p.p.), gjatë këtij tremujori kishte një rënie të eksportit të shërbimeve të ndërtimit me një kontribut negativ prej (2.1 p.p.) dhe atyre të udhëtimit me kontribut negativ prej (2.0 p.p.).
- Importi i shërbimeve kishte një rritje vjetore prej 7.2%, kryesisht si rezultat i rritjes së importit të transportit dhe udhëtimit të cilat kontribuuan me (4.2 p.p.) dhe (4.1 p.p.), respektivisht. Ndërsa importi i shërbimeve të ndërtimit dhe atyre kompjuterike kishin një kontribut negativ prej (3.3p.p.) dhe (1.5 p.p.), respektivisht.
- Vlen të theksohet që në muajin mars, atëherë kur filluan masat për parandalimin e spërhapjes së virusit Covid-19, dinamika e importit dhe eksportit ndryshoi kah. Muaji mars u karakterizua me rënie në importin e mallrave si në vlerë ashtu dhe në sasi. Në të njëjtën kohë, edhe importi i shërbimeve kishte një rënie vjetore të theksuar gjatë muajit mars. Ndërsa, eksporti i mallrave

⁶ Inflacioni i tregtueshëm mat ndryshimin e çmimeve të atyre produkteve që janë të ekspozuara ndaj tregtisë në tregjet ndërkombëtare dhe rrjedhimisht çmimet e tyre nuk ndikohen nga zhvillimet në tregun lokal. Ndërsa, inflacioni i patregtueshëm mat ndryshimin e çmimeve të atyre produkteve që nuk tregtohen në tregjet ndërkombëtare dhe rrjedhimisht ndikohen nga tregu i brendshëm lokal.


në muajin mars në terma të sasisë shënoi rënie, ndërsa në vlerë kishte një rritje prej 8.7%, e cila është më e ngadaltë se rritja në dy muajt paraprakë të 2020-ës.

Table 2 Indikatorët mujorë

Indikatori, v-m-v, %	Janar '20	Shkurt '20	Mars '20
Importi i Mallrave	16.2%	13.2%	-12.8%
Importi i Shërbimeve	10.1%	24.1%	-10.2%
Eksperti i Mallrave	23.1%	49.1%	8.7%
Eksperti i Shërbimeve	13.7%	19.7%	-44.6%

Si rezultat i zhvillimeve në totalin e importeve dhe eksporteve, deficitin tregtar të mallrave dhe shërbimeve në tremujorin e parë është rreth 4.6% më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Grafiku 6 Llogaria rrjedhëse



Bilanci i të ardhurave parësore për tremujorin e parë 2020 ka shënuar një rënie prej 12.3%, duke arritur një vlerë prej 46 milionë euro, kryesisht si rezultat i daljeve më të larta të nga kategoria e investimeve. Bilanci i të ardhurave dytësore për këtë tremujor arriti vlerën prej 312 milionë euro, që është 8.3% më i lartë se bilanci në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo

rritje i atribuohet kryesisht rritjes së bilancit të transfereve të korporatave financiare, jo-financiare, dhe ekonomive familjare (6.2 %, v-m-v) dhe transfereve zyrtare qeveritare (28.0%, v-m-v).

Duke qenë se bilanci i të ardhurave dytësore dominohet nga hyrjet e remitencave, vlen të ceket se ato në këtë tremujor shënuan një rritje vjetore prej 1.4% që ishte shumë më e ngadaltë se sa rritja historike. Kjo kryesisht për shkak se në muajin mars, tendenca rritëse e remitencave ndërroi kah (rënie 13.9%, v-m-v). Përveç kësaj, gjatë muajit mars kishte një ndryshim të dukshëm në kanalet e dërgimit të remitencave. Pjesëmarrja e remitencave të dërguara përmes agjencive për transfer të mjeteve u rrit me rreth 16% krahasuar me periudhën e njëjtë të 2019-ës. Kjo vjen si rezultat i mbylljes së kufijve të Kosovës dhe të vendeve të Evropës prej nga dërgohen remitencat (në gjysmën e dytë të muajit mars), që ndikoi në rënien e dërgimeve përmes kanaleve tjera që janë kryesisht në formë të parave të gatshme.


Grafiku 7 Remitencat sipas kanaleve të dërgimit



Përkundër një përqendrimi në bilancin tregtar të shërbimeve dhe bilancit të të ardhurave parësore, bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje ndërsa bilanci tregtar i mallrave mbeti i pandryshuar. Si rrjedhojë, bilanci i llogarisë rrjedhëse për tremujorin e parë të 2019-ës ishte -84.6 milionë euro, që është në nivel të ngjashëm me deficitin e regjistruar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak kur bilanci i llogarisë rrjedhëse kishte vlerë prej -82.4 milionë euro.

Llogaria Financiare

Grafiku 8 Llogaria Financiare



○ Bilanci i llogarisë financiare për tremujorin e parë të 2020-ës është zvogëluar me rreth 62.4 milionë euro, si rezultat i rritjes në prurjet e investimeve të huaja direkte.

○ Gjatë kësaj periudhe, hyrjet totale të IHD-ve kishin një rritje prej 60.5% duke arritur vlerën 42.2 milionë euro, krahasuar me periudhën e njëjtë të 2019-ës. Ky zhvillim erdhi kryesisht nga hyrjet e IHD-ve në sektorin e energjetikës e cila kishte një kontribut prej 33.4 p.p. në këtë rritje. Megjithatë, tendenca mujore tregon se në muajin mars kishte një rënie në hyrjet e IHD-ve prej 6.3%, kryesisht për shkak të një rënie në sektorin e patundshmërisë.

Sektori Financiar

○ Tremujori i parë i vitit 2020 u karakterizua me një rritje të theksuar vjetore të kredive të reja prej 28.4%. Kjo i atribuohet rritjes prej 41.6% në kreditë e korporatave jo-financiare dhe një rritje prej 10% në kreditë e ekonomive familjare.

- Depozitat e reja në tremujorin e parë shënuan një rritje vjetore prej 5.6%. Kjo rritje ishte e shtyrë kryesisht nga rritja e depozitave të ekonomive familjare për 17%, përkundër një rënie në depozitat e korporatave jo-financiare prej 17.8%. Megjithatë, tendenca mujore tregon që muaji mars u karakterizua me një rënie të depozitave të reja prej 38.1%.
- Norma efektive e interesit për kreditë e reja për tremujorin e parë të vitit 2020 ishte mesatarisht 6.4%, ndërsa ajo për depozitat e reja ishte mesatarisht 1.5%.
- Kreditë jo-performuese gjatë tremujorit të parë ishin 2.4% të totalit të kredive, duke treguar një përmirësim nga tremujori i parë i vitit të kaluar (2.6%).

Tabela 3 Indikatorët e Sektorit Financiar

	2018				2019				2020
	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1
Depozitat e reja % Δ	20.6	19.0	17.9	36.1	0.8	22.6	-0.1	-5.9	5.6
Kreditë e reja % Δ	14.6	12.3	-3.7	0.7	-5.0	1.8	26.1	1.5	28.4
Norma efektive e interesit në kredi të reja	6.9	6.7	6.7	6.3	6.7	6.4	6.4	6.4	6.4
Norma efektive e interesit në depozita të reja	1.1	1.2	1.5	1.4	1.5	1.4	1.4	1.5	1.5
Kreditë jo-performuese	3.0	2.9	2.8	2.7	2.6	2.6	2.3	2.2	2.4

Tregu i Punës

- Publikimi i rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore për 2020 T1 është shtyrë për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID19. Si rrjedhojë, të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për tregun e punës nuk do të jenë në dispozicion deri në muajin korrik.
- Megjithatë, të dhënat e punësimit formal nga Administrata Tatimore e Kosovës tregojnë që në tremujorin e parë të 2020-ës kishte një rritje në numrin e të punësuarve prej 7.7%.
- Kontributin më të lartë në këtë rritje kishin sektorët e industrisë përpunuese dhe tregtia me shumicë e pakicë (1.6 p.p. secila).
- Kontribut tjetër pozitiv kishin edhe akomodimi e shërbimi ushqimor me 1.2 p.p. dhe informimi me 1.1 p.p..
- Ndërsa, sektori i transportit kishte një kontribut negativ prej 0.7 p.p..

Regjistri i bizneseve, T1 2020

- Numri i bizneseve të reja gjatë tremujorit të parë të 2020-ës ishte 2,311 (93 biznese më pak të regjistruara se periudha e njëjtë e vitit të kaluar) apo 3.9% më i ulët.
 - 590 biznese të reja në kategorinë e tregtisë (6 më pak se T1 2019)
 - 363 biznese të reja në kategorinë e prodhimit (86 më shume se T1 2019)
 - 270 biznese të reja në akomodim dhe shërbime ushqimore (30 më shumë se T1 2019)
 - 225 biznese të reja në aktivitetet profesionale dhe shkencore (28 më pak se T1 2019)

- Struktura e bizneseve të reja dominohet nga ndërrmarjet mikro (2,273 ndërrmarrje) dhe ndërrmarjet e vogla (34 ndërrmarrje). Ndërsa vetëm 1 ndërrmarrje e mesme dhe 3 të mëdha u regjistruan në këtë tremujor.
- Numri i bizneseve të shuara gjatë T1 2020 arriti në 430. Shuarja e bizneseve ka qenë më e theksuar në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë (rreth 1/3 e tyre).
- Sipas prejardhjes së kapitalit, pjesa dërrmuese ishin me kapital vendor (2,301 ndërrmarrje) dhe vetëm 10 prej tyre ishin me kapital të huaj.

Financat Publike

Të hyrat

- **Të hyrat e përgjithshme** arritën në 397.3 milionë euro gjatë tremujorit të parë të 2020-ës, duke shënuar një rritje vjetore prej 2.2% krahasuar me tremujorin e parë të vitit paraprak. Megjithatë, në muajin mars tendenca rritëse ndryshoi kah dhe të hyrat e përgjithshme buxhetore shënuan rënie vjetore prej 13.7%.
- **Të hyrat tatimore** për këtë periudhë gjithashtu kishin një rritje prej 2.8% krahasuar me T1 2019, mirëpo muaji mars u karakterizua me një rënie të theksuar prej 26.2%. Kjo i atribuohet kryesisht efekteve negative të masave për të parandaluar COVID 19, të cilat ndikuan në rënien e aktivitetit ekonomik dhe rrjedhimisht në rënien e importeve, dhe shtyerjes së pagesave të tatimeve.
- **Të hyrat direkte** arritën vlerën 65.9 milionë euro dhe paraqesin 18.7% të total të hyrave tatimore për këtë periudhë dhe janë për 3.4% më të ulta në krahasim me periudhën e njëjtë e vitit të kaluar.
 - Të hyrat nga Tatimi në të ardhura të Korporatave arritën në 20.8 milionë euro dhe shënuan rënie vjetore prej rreth 6.0%, e cila erdhi kryesisht nga rënia e konsiderueshme në muajin mars (-67.7% v-m-v).
 - Të hyrat nga Tatimi në të Ardhurat Personale shënuan rënie prej 0.5% nga periudha e njëjtë e vitit paraprak. Përkundër një rritjeje në dy muajt e parë të 2020-ës, tendenca rënëse filloi në muajin mars ku u shënuar një rënie prej 10.1%.
 - Të hyrat nga Tatimi në Pronë shënuan një rritje prej 3.9% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar mirëpo kishin një rënie duke filluar nga muaji mars (-29.9%) e cila u shkaktua kryesisht nga vendimi për shtyerjen e pagesave.
- **Të hyrat indirekte** në kishin një rritje rreth 3.3% e cila është shumë më të ngadaltë se sa vitin paraprak. Përkundër një performance të mirë në janar dhe shkurt, muaji mars kishte një rënie prej 9.0%.
 - Të hyrat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (vendore dhe kufitare) kishin një rritje dukshëm më të ngadaltë se sa periudha paraprake. Rritja prej vetëm 3.2% në TVSH vendore dhe 5.4% në TVSH kufitare ishte kryesisht për shkak të një rënieje të theksuar në muajin mars (-40.5% dhe -7.8%, respektivisht). Arsyeja kryesore për rënien në TVSH kufitare në muajin mars ishte niveli më i ulët i importeve. Ndërsa për TVSH vendore, përveç një rënie në konsum, efekt të konsiderueshëm kishte edhe vendimi për shtyerjen e pagesave.

- Pas një rritjeje në të hyrat nga detyrimi doganor në janar dhe shkurt, tendenca rënëse filloi në muajin mars (-18.8% v-m-v). Kështu që, në T1 2020 të hyrat nga detyrimi doganor në janë rreth 6.7% më të ulta në krahasim vitin paraprak.

- Ndërsa, të hyrat nga akciza kishin një rritje prej 3.4% në terma vjetorë e cila ishte më e ngadaltë se sa viti i kaluar.

- **Të hyrat jo-tatimore** gjithashtu shënuan një rënie vjetore prej 2.1%, ndikuar kryesisht nga rënia në muajin mars prej 38.7%.

Shpenzimet


- **Shpenzimet e përgjithshme** për tremujorin e parë të 2020-ës arritën vlerën prej 398.2 milionë euro dhe ishin rreth 0.5% më të ulta se sa në periudhën e njëjtë e vitit të kaluar.

- **Shpenzimet rrjedhëse** në tre mujorin e parë të vitit 2020, arritën vlerën prej 345.4 milionë euro apo një rritje vjetore prej 1.9%. Rritja erdhi kryesisht nga rritja në kategorinë e pagave dhe kategorinë e subvencioneve e transfereve. Ndërsa, kishte një rënie prej 5.9% në shpenzimet për mallra dhe shpenzime si pasojë e fillimit të masave kufizuese në gjysmën e muajit mars.


- **Shpenzimet kapitale** shënuan rënie vjetore prej 34.9% në T1 2020. Tendenda rënëse ishte gjatë muajit shkurt dhe muajit mars erdhi kryesisht për shkak të ngecjeve në formimin e qeverisë, mungesës së buxhetit të aprovuar dhe fillimit të masave kufizuese lidhur me COVID19.

- **Ndërsa, shpenzimet e interesit** arritën vlerën prej 9.1 milionë euro në T1 2020 dhe shënuan rritje vjetore prej 19.0%.

Grafiku 9 Kontributet në të hyrat buxhetore



Grafiku 10 Kontributet në shpenzime buxhetore



Bilanci i përgjithshëm buxhetor

- **Bilanci i përgjithshëm kumulativ** buxhetor arriti në 190.8 milionë €, ndërkohë bilanci buxhetor sipas rregullës fiskale arriti 34.2 milionë € apo 0.5% të BPV-së, duke qëndruar kështu brenda rregullës fiskale.

- **Bilanci përgjithshëm bankar** në fund të tremujorit të parë arriti vlerën prej 369.7 milionë euro ose 5.3% e BPV-së (duke respektuar rregullën fiskale prej më së paku 4.5%).

Informata të Tjera: Reagimi i Autoriteteve Publike Ndaj Pandemisë Covid-19 në Kosovë

Situata pandemike Covid-19, e cila filloi të përhapej dukshëm në fund të muajit shkurt 2020, ka shkaktuar (dhe vazhdon të shkaktojë) kosto të larta njerëzore në të gjithë botën. Masat e nevojshme të izolimit apo kufizimit të lëvizjes së njerëzve që janë ndërmarrë për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të kësaj pandemie e ndikojnë ndjeshëm negativisht aktivitetin ekonomik. Sipas projeksioneve më të fundit të Bankës Botërore dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar, ekonomia në nivel global pritet të shënojë rënien më të madhe që prej Depresionit të Madh, me vlerësime që luhaten rreth -5.2% dhe -3.0%, respektivisht. Në përgjigje të kësaj situatë, pothuajse të gjitha vendet e prekura kanë ndërhyrë duke përdorur mjetet që kanë në dispozicion me qëllim zbutjen e ndikimit të efektit të pandemisë. Këto ndërhyrje kryesisht kanë qenë të natyrës fiskale, monetare dhe makroprudenciale.

Shumë banka qendrore kanë siguruar likuiditet shtesë në sistemin financiar nëpërmjet uljes së normës bazë të interesit në rast se kanë pasur hapësirë ose nëpërmjet programeve të lehtësimit sasior duke blerë bono qeveritare apo aktive të bankave tregtare, ose korporatave. Disa instrumente të tjera të përdorura nga bankat qendrore konsistojnë në uljen e rezervës së detyruar; në shtyrjen e pagesave të kësteve të kredisë apo në ristrukturimin dhe zgjatjen e kredive për individët dhe bizneset që janë ndikuar më së shumti nga pandemia; dhe në lehtësimin nga detyrimi i mbajtjes së kapitalit amortizues kundër-ciklik. Është e vështirë të gjykohej mbi efektin që këto instrumente të politikave monetare kanë pasur në zbutjen e pasojave të situatës pandemike për shkak të vonësës kohore të reagimit të politikës monetare. Megjithatë, shumë ekonomi të zhvilluara nuk kanë pasur shumë hapësirë për uljen e mëtejshme të normës bazë së interesit duke qenë se ato prej një kohe të gjatë kanë funksionuar në kushtet e normave të interesit në nivele shumë afër zeros. Ndërsa në disa vende të tjera, mungesa e politikës monetare e ka limituar mjaft ndikimin e bankave qendrore në luftimin e pasojave negative të masave kufizuese të ndërmarra gjatë pandemisë.

Në kombinim me masat monetare dhe makroprudenciale, vendet kanë ndjekur një politikë fiskale stimuluese, si një nga mënyrat më të shpejta dhe më efikase për të adresuar tkurrjen ekonomike. Masat e ndërmarra nga politika fiskale kanë premtuar mbështetje fiskale për gjithë individët apo firmat që kanë pasur humbje të të ardhurave me qëllim shmangien e largimeve në masë nga puna dhe lehtësimin e rikuperimit të shpejtë pas heqjes së kufizimeve. Madhësia dhe lloji i masave fiskale të marra kanë qenë mjaft të varura nga hapësira fiskale dhe çasja në financa që ka pasur secili vend.

Më 30 Mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi **Vendimin për Pakon Emergjente Fiskale**, e cila synon të adresojë problemet ekonomike-sociale të shkaktuara nga pandemia COVID-19. Kjo pako konsiston gjithsej në 15 masa, të cilat kanë si qëllim ndihmesën e menjëhershme të qytetarëve apo të atyre bizneseve që janë dëmtuar më së shumti nga kufizimet e vendosura nga qeveria në lidhje me kufizimin e ushtrimit të aktivitetit ekonomik për disa sektorë dhe të lëvizjes së qytetarëve. Vlera e kësaj pako arrin në 180 milionë Euro dhe përbën rreth 2.4% të Bruto Produktit Vendor. Synimi i këtyre masave nuk është kompensimi i të gjitha efekteve negative por orientohet drejt minimizimit të dëmeve të shkaktuara nga kjo situatë emergjente e shëndetit publik.

Ky stimul erdhi kryesisht në formën e subvencioneve dhe transfereve si për individët ashtu edhe për kompanitë. Një stimul i tillë, duke mbajtur gjithçka konstante, ka një kontribut pozitiv pothuajse të papërfillshëm pozitiv në rritjen reale të PBB-së prej rreth 0.2 p.p. ose rreth 15-20 milionë në vlerë të shtuar.⁷ Kjo është kryesisht në përputhje me teorinë ekonomike pasi që stimujt fiskalë të dhënë në formë transferesh kanë një shumëzues (multiplikator) mjaft të ulët ose zero pasi transferet janë kryesisht para të transferuara në një ekonomi nga një agjent në një tjetër pa ndonjë vlerë të shtuar. Megjithatë, ekzistojnë gjithashtu mendime se në rast se transfere të tilla synohen mirë dhe u jepen individëve me një prirje më të lartë për të konsumuar, atëherë kjo mund të ketë një ndikim pozitiv në kërkesën agregate. Sidoqoftë, kjo analizë duhet të analizohet më tej pas vëzhgimit të tregut të Kosovës pas shpërndarjes së këtyre transfereve pasi rritjet e tilla të konsumit mund të kenë një prirje importi që më pas mund të ulë ndikimin pozitiv të transfereve. Sidoqoftë, transferimi i burimeve nga ekonomitë me prirje marginale për të konsumuar në ato me prirje më të lartë mund të ndihmojë në një vend të rrisë kërkesën agregate dhe kështu të rrisë prodhimin. Nga ky këndvështrim, shpenzimet fiskale për transfere mund të stimulojnë aktivitetin ekonomik në një recesion, por vetëm nëse janë të mirë targetuara.

Më konkretisht, masat përbërëse të kësaj **Pakos Emergjente Fiskale miratuar nga Qeveria** janë:

- i) Pagesë e dyfishtë e skemës sociale (*buxhetuar rreth 7.7 milionë Euro*);
- ii) Pagesë shtesë përfituesve të skemave sociale dhe pensionale me pagesë mujore më të ulët se 100 euro (*buxhetuar rreth 13 milionë Euro*)
- iii) Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që janë në vështirësi financiare: a) mbulimi i shpenzimeve të pagave mujore të punonjësve (*41 milionë Euro buxhetuar*); b) subvencionimi i qirasë për NVM (*12 milionë Euro buxhetuar*); c) mbulimi i vlerës së kontributeve personale për pagat në pikën a (*8 milionë Euro buxhetuar*).
- iv) Sigurimi i huadhësnies pa interes për ndërmarrjet publike, me kthim deri në fund të vitit (*buxhetuar rreth 20 milionë Euro*)
- v) Sigurimi i mbështetjes financiare për komunat të ndikuara nga pandemia (*10 milionë Euro buxhetuar*)
- vi) Pagesë shtesë mujore prej 100 Euro për dy muaj për punëtorët e dyqaneve ushqimore, furrave dhe barnatorëve (*buxhetuar rreth 3 milionë Euro*);
- vii) Pagesë e asistencës mujore prej 130 Euro për dy muaj për punëtorët që humbin vendin e punës për shkak të situatës (*buxhetuar rreth 4 milionë Euro*);
- viii) Mbështetja e iniciativave dhe projekteve që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve jo shumicë, që janë goditur më rëndë nga situata (*buxhetuar rreth 5 milionë Euro*);
- ix) Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (*buxhetuar rreth 5 milionë Euro*)
- x) Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë për rritje të prodhimit bujqësor (*buxhetuar rreth 5 milionë Euro*)

⁷ Ky vlerësim është përfutur nga Modeli Makro- Fiskal, i përdorur nga Ministria e Financave për të përfutur projeksionet afatmesme makro-fiskale.

- xi) Sigurimi i likuiditetit financiar për mikro-ndërmarrjet, të vetpunësuarit apo shoqëritë tregtare/kompanitë që ofrojnë shërbimë bazike nëpërmjet programeve të caktuara të FKGK-së (*buxhetuar rreth 15 milionë Euro*).
- xii) Mbështetje për eksportuesit pas përfundimit të situatës së emergjencës;
- xiii) Mbështetje financiare me 130 Euro/muaj për dy muaj për shoqëritë tregtare që regjistrojnë punëtorët me kontratë punë së paku (1) vjeçare gjatë periudhës së situatës së emergjencës (*buxhetuar rreth 6 milionë Euro*).
- xiv) Pagesa e asistencës mujore prej 130 Euro për dy muaj për qytetarët me kushte të rënda sociale, të lajmëruar si të papunë në institucionin kompetent dhe që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga buxhet i Kosovës (*buxhetuar rreth 3 milionë Euro*).
- xv) Mbështetje financiare për ndërmarrjet publike (*buxhetuar rreth 20 milion Euro*)

Për më tepër, ka pasur shpenzime shtesë prej 10 milionë Euro, që i janë alokuar Ministrisë së Shëndetësisë për të mbuluar shpenzimet që lidhen me luftimin ndaj situatës Covid-19. Ndërkohë **Administrata Tatimore e Kosovës**, me qëllim që të krijojë sa më shumë lehtësime për qytetarët dhe bizneset, ka vendosur të zgjasë afatin për dorëzimin e deklaratave, raporteve deri në 15 Maj të këtij viti për deklaratat mujore (TVSH, kontribute, qera, etj) dhe deri në 30 Qershor për pagesën e pasqyrave tremujore.

Banka Qendrore e Kosovës (BQK), në mungesë të politikës monetare, ka qenë më e kufizuar në përdorimin e mjeteve për të stimuluar aktivitetin ekonomik. Më konkretisht:

- Është pezulluar përkohësisht pagesa e kësteve të kredisë bazuar në analizën rast pas rasti me qëllim që këto të përfitime të shkojnë vetëm tek ata, të cilët janë prekur nga kriza aktuale. Në rast të miratimit të një kërkesë të tillë nga banka, nuk do të aplikohet asnjë masë e përkeqësimit të vlerësimit të kredisë apo interesa ndëshkuese dhe nuk do të kërkohet asnjë provizion shtesë nga bankat.
- Është siguruar funksionimi i rregullt i sistemit të pagesave në mbarë Kosovën, përfshirë këtu zonat e prekura, të cilat kanë qenë të izoluara për një periudhë të caktuar kohore.

Pako Emergjente Fiskale nuk është implementuar ende plotësisht, për shkak të pamundësisë së rishikimit të Buxhetit, e kushtëzuar nga situata politike deri në muajin qershor. Me miratimin e Buxhetit të rishikuar nga Parlamenti, pjesa e mbetur e Pakos do të vazhdojë të implementohet dhe do të pasohet nga **Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike**, i icli pritet të jetë rreth 1.2 miliardë Euro, e shpërndarë në pjesën e dytë të këtij viti (2020) dhe vitin e ardhshëm (2021). Ky Program Rimëkëmbje pritet të ndikojë perspektivën afatmesme të ekonomisë duke rigjallëruar ekonominë, prodhimin dhe punësimin pas përfundimit të pandemisë dhe heqjes së masave kufizuese.